

**Pandemia dhe rritja e çmimeve
“shtrydhin” qytetarët**



Faqe 2

**Qytetarë, zyrtarë qeveritarë e deputetë
në Shqipëri për fundjavë**



Faqe 3

**Rusët kujtojnë me krenari
pushtimin
e gjithësisë**



Faqe 6

**“Në kërkim të Venerës” triumfues
i dyfishtë në një prej festivaleve
më të vjetra në Azi**



Faqe 11

e hënë • 12 prill 2021

Numri 8524 • Çmimi 0,50 €

KOHA

DITORE

www.koha.net



KËRKOHET RIVENDOSJE E NEGOCIATAVE MES KOSOVËS DHE SERBISË, PENGESAT I ATRIBUOHEN PERËNDIMIT

Çështja kryesore e politikës së jashtme konsiderohet dialogu me Serbinë

Qeveria e cila është proces të hartimit të programit, nuk e ka zbardhur ende qasjen në raport me dialogun me Serbinë. Derisa në programin prej 52 faqesh të Lëvizjes Vetëvendosje nuk ishte përmendur fare dialogu me shtetin serb, referuar programit të Qeverisë Kurti 1, ishte thënë se angazhimi do të jetë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë përmes dialogut dhe në frymën e parimit të reciprocitetit. Analistët shohin pengesa në arritjen e një marrëveshjeje finale për njohjen reciproke

Fitim Gashi

PRISHTINË, 11 PRILL - Dialogu me Serbinë është çështja kryesore e politikës së jashtme që i përshkruhet Qeverisë Kurti.

Pak ditë pas vendosjes në krye të ekzekutivit, Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Çështjes të Sigurisë, Joseph Borrell, i ka kërkuar kryeministrit të vazhdojë sa më shpejt dialogun me Serbinë, teksa këtë e ka ndërlidhur me perspektivën evropiane të vendit.

Qeveria që aktualisht është në proces të hartimit të programit, nuk e ka zbardhur ende qasjen që do ta ketë në raport me dialogun.

Zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, ka thënë se veprimet kryesore të qeverisë për katër vjetet e ardhshme do të përcaktohen në Programin e Qeverisë dhe Planin e Veprimit.

“Për hartimin e tyre kërkohet koordinim dhe diskutim më të gjitha ministrat dhe ne tashmë jemi drejt finalizimit të këtyre dokumenteve”, ka thënë ai.

Njohësi i çështjes së Ballkanit, Bodo Weber, pret shtim të presionit nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara për rinisje të negociatave dhe arritjen e një

marrëveshjeje finale.

“Dialogu për një marrëveshje finale gjithmonë ka qenë çështje specifike jo vetëm për politikën e jashtme se çfarë prioriteti i jep qeveria, por edhe për atë të brendshme, kur dihet se në të kaluarën ka qenë subjekt i diskutimit edhe territori dhe sovraniteti i Kosovës. Sidoqoftë, edhe pse qeveria për arsye të mira do të ballafaqohet me prioritetet tjera sikurse është menaxhimi i pandemisë dhe pavarësisht deklaratave të Kurtit se nuk e ka prioritet, mendoj se dialogu do të jetë top-prioritet për shkak të presionit nga SHBA-të dhe BE-ja”, ka theksuar Weber.

Ai ka shtuar se pengesat në arritjen e marrëveshjes mund të vijnë nga perëndimi, për shkak të humbjes së besueshmërisë shkaku i diskutimeve për kufijtë.

“Për të pasur rivendosje të negociatave nuk mjafton ta kemi Borrellin, Lajçakun apo Palmerin nga SHBA-ja në proces, por duhen politika të qarta, ku bashkë BE-ja dhe SHBA-ja i shmangin diskutimet për kufijtë dhe japin sinjal të qartë se zgjerimi drejt vendeve të Ballkanit nuk do të ndalet.

vijon në faqen e tretë



Autobusë e dhjetëra vetura nga Kosova shihen të parkuara në një pompë benzine në Rugën e Kombit. Në fakt, edhe të dielën, mijëra qytetarë nga Kosova ia kanë mësyre Shqipërisë. Sipas të dhënave nga Qeveria e Kosovës, vetëm të premten e të shtunën, kufirin Kosovë – Shqipëri e kanë kaluar rreth 29 mijë qytetarë. Shumëkush shkuarjen në Shqipëri për vikend në kohë pandemie e ka arsyetuar me masat e marra në Kosovë për mbylljen e gastronomisë dhe qendrave tregtare, por për Qeverinë kjo qëndron

BASHKIMI EVROPIAN ENDE NUK KA VAKSINA PËR T’IU DHËNË VENDEVE TË BALLKANIT

Autoritetet nacionale mund t’i aprovojnë vaksinat që nuk i ka aprovuar BE-ja

Augustin Palokaj

BRUKSEL, 11 PRILL - Vaksinimi në vendet e Bashkimit Evropian ka marrë hov ditëve të fundit pas dështimeve që të përmbushet plani për tremujorin e parë të vitit. Tashmë është stabilizuar në një masë shpërndarja e vaksinave dhe në tremujorin e dytë, që ka nisur nga 1 prilli, BE-ja pret rreth 360 milionë vakcina.

Krahas rreth 100 milionë që kanë ardhur në tre muajt e parë, deri në fund të qershorit BE-ja planifikon të vaksinojë diku me 50 deri në 70 për qind të popullatës të moshës madhore, mbi 18 vjeç.

Në këtë moment, në BE së paku një dozë të vaksinës e kanë marrë mbi 16 për qind e qytetarëve. Po ashtu është zvogëluar dukshëm edhe dallimi mes shteteve dhe shumica e tyre sillen aty rreth mesatares. Dallim bëjnë Hungaria dhe Malta, që kanë vaksinuar më së paku një dozë mbi 30 për qind të qytetarëve dhe Bullgaria që ka ngecur në rreth 7 për qind.

Dallimi i krijuar është rezultat i llojit të vaksinës që kanë porositur dhe përdorin vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ato që kanë porositur më shumë nga “BioNtech/Pfizer” kanë kaluar më mirë, sepse kjo kompani, pas disa mone-save, në fazën fillestare e ka për-

shpejtuar shpërndarjen e vaksinave. Ato shtete të cilat kanë porositur më shumë nga kompania “AstraZeneca” kanë ngecur më shumë, sepse kjo kompani ka shpërndarë vetëm një numër të kufizuar dozash, shumë më pakë sesa që ishte e obliguar në bazë të kontratave. Hungaria në anën tjetër ka vaksinuar më së shumti qytetarë për shkak se ajo ka nisur edhe përdorimin e vaksinave nga Kina e Rusia, pa prituri që për këtë, autorizimin ta jep Agjencia Evropiane e Barnave (EMA).

Përkundër faktit se vaksinimi në BE ka hyrë në një dinamikë sadopak të kënaqshme, asnjë dozë nga BE-ja përmes shteteve

anëtare nuk i është dhënë Kosovës, e as ndonjë shteti tjetër të rajonit. Në këtë mënyrë BE-ja nuk e ka përmbushur një premtime të dhënë që në fund të vitit të shkuar se do t’i ndihmojë vendet e Ballkanit në fazën fillestare, derisa të mos marrin sasi më të mëdha të vaksinave përmes nismës “Covax”, nga e cila nismë Kosova do të marrë një sasi dozash edhe falas, pasi është ndër vendet më të varfra të botës.

Sasia e parë e vaksinave që ka mbërritur në Kosovë ka mjaftuar që së paku të thuhet se procesi i vaksinimit ka nisur.

vijon në faqen e dytë

**Java e Evropianit
për sportistët më të
suksesshëm në vend**



Pas një përvoje të pazakontë në edicionin e kaluar, xhudistët kosovarë kthehen në ngjarjen kryesore kontinentale me synime të qarta - për të konfirmuar nivelin, për të fituar medalje dhe për të dëshmuar se janë në rrugë të duhur për ngjarjen më të madhe sportive. Kampionati Evropian i vitit 2021 në xhudo mbahet në Lisbonë të Portugalisë prej 16 deri...

Faqe 17

KËRKOHET RIVENDOSJE E NEGOCIATAVE MES KOSOVËS DHE SERBISË, PENGESAT I ATRIBUOHEN PERËNDIMIT

Çështja kryesore e politikës së jashtme konsiderohet dialogu me Serbinë

Qeveria e cila është proces të hartimit të programit, nuk e ka zbardhur ende qasjen në raport me dialogun me Serbinë. Derisa në programin prej 52 faqesh të Lëvizjes Vetëvendosje nuk ishte përmendur fare dialogu me shtetin serb, referuar programit të Qeverisë Kurti 1, ishte thënë se angazhimi do të jetë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë përmes dialogut dhe në frymën e parimit të reciprocitetit. Analistët shohin pengesa në arritjen e një marrëveshjeje finale për njohjen reciproke

vijon nga ballina

Pra, pengesat nuk i shoh te kompromisi dhe zgjidhja eventuale mes Kosovës dhe Serbisë, por te besueshmëria në proces për shkak të dëmtimit të tij nga aktorët perëndimorë tre apo katër vjetët e fundit”, ka shtuar ai.

Sipas tij, shumica prej ndërkom-bëtarëve, ka pasur frikë se idetë dhe opsionet për shkëmbime janë mbështetur nga ish-zyrtarë amerikanë dhe ish-ndërmjetësuesja e dialogut, Mogherini.

“Arritja e një marrëveshjeje është mundësi që nuk duhet të humbet dhe në këtë kuptim shenjat e para nga administrata aktuale e SHBA-së janë inkurajuese dhe shpresëdhënëse se do të lëvizet shpejt drejt rivendosjes së negociatave. Kjo nënkupton që presidenti Biden dhe kancelarja Merkel duhet t’i vendosin parimet e një kornizë të qartë negociuese ku njohja e ndërsjellë ndodhë në fund të procesit”.

Analisti gjerman thotë se nëse Serbia e synon integrimin në BE-së ashtu siç e proklamoi, duhet ta pranojë realitetin se çështja e statusit të Kosovës është mbyllur dhe të shikohen mundësitë se si të zgjidhen të gjitha çështjet e hapura mes dy vendeve.

Në programin prej 52 faqesh, Lëvizja Vetëvendosje nuk ka përmendur fare dialogu me shtetin serb.

Referuar programit të Qeverisë Kurti 1, te pjesa e dialogut ishte thënë se angazhimi do të jetë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë përmes dialogut dhe në frymën e parimit të reciprocitetit.

Zyrtarë të qeverisë as tani nuk e kanë përjashtuar mundësinë e vendosjes së kësaj mase, e cila pati çuar në përplasje të mëdha me ish-ad-

ministratën e presidentit amerikan Donald Trump.

LDK-ja kishte iniciuar mocionin për rrëzimin e qeverisë, me arsyen se po rrezikohen marrëdhëniet me SHBA-në.

Temat e dialogut

E çështjet të cilat qeveria zotohej t’i negocionte janë të pagjeturit, reparacionet e luftës, suksedimit të ish-Federatës Jugosllave në të cilën Kosova ishte element konstituiv, si dhe për njohje të ndërsjellë midis shteteve.

Mbështetur në programin e qeverisë Kurti 1, temë e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë nuk mund të jenë çështje që lidhen me integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit, me rregullimin dhe funksionalitetin e brendshëm të vendit.

Po ashtu është përjashtuar krijimi i një pushteti të tretë administrativ për vendbanime me popullsi të veçanta etnike është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës së Kosovës.

Megjithëkëtë, çështja e cila mund ta zbehtë entuziazmin e palëve për një marrëveshje finale dhe gjithëpërfshirëse është Asociacioni i Komunave Serbe, kundër të cilit është Lëvizja Vetëvendosje.

Themelimi i këtij mekanizmi vazhdon të jetë edhe kërkesë e Bashkimit Evropian, duke rikujtuar se Kosova ka marrë obligime në marrëveshjen e prillit të vitit 2013, si dhe marrëveshjen e parimeve të Asociacionit më 2015. Por, Gjykata Kushtetuese pati konstatuar shkelje në të shtatë kapitujt e asaj marrëveshjeje, duke kërkuar që përmirësimet e nevojshme të bëhen me rastin e draftimit të statutit.

Duke iu përgjigjur deklaratës së

Bashkimit Evropian, ku është rithek-suar se Kosova duhet ta formojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe, Kurti ka thënë më herët se mund të ketë asociacion të komunave të Bjeshkës së Rugovës apo maleve të Sharrit, por jo asociacion një etnik.

Qeveria pati paraparë edhe një rishikim të plotë të marrëveshjeve të arritura deri më tani, me qëllim të analizimit të shkallës së zbatimit të tyre nga ana e Serbisë, dhe siç thuhej, në bashkëpunim me BE-në, të shtrohen këto çështje në tavolinën e dialogut. Parashihej edhe miratimi i një platforme për dialog dhe e njëjta të miratohet në Kuvendin e Kosovës, me synim arritjen e 2/3 të votave, e cila do të përfshijë parimet, në bazë të të cilave duhet të zhvillohet dialogu.

Gjatë javës, presidentja Vjosa Osmani, e ka siguruar ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, se do të angazhohet që të krijojë një platformë të mirëfilltë të dialogut me gjithë spektrin politik, duke cekur se theks të veçantë do t’u japë konsultimeve me opozitën si dhe përfshirjen e saj në mënyrë aktive në çështje të interesit të veçantë për vendin.

Nëpërmjet Aktgjykimit nr.KO43/19, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se kryeministri i vendit është ai që udhëheq me dialogun, duke u këshilluar edhe me presidenten.

Borrell kërkon rinisjen e negociatave

Ende nuk dihet se kur do të rinisin takimet e nivelit të lartë. Por në letërën e tij dërguar Kurtit, Borrell ka thënë se me dëshirë do t’i ftojë për takimin e ardhshëm të nivelit të lartë të dialogut sa më shpejt të jetë e



Pak ditë pas vendosjes në krye të ekzekutivit, Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Çështjes të Sigurisë, Joseph Borrell, i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti të vazhdojë sa më shpejt dialogun me Serbinë, teksa këtë e ka ndërlidhur me perspektivën evropiane të vendit

mundur dhe se qëndron fort i vendosur për të ndihmuar të dy palët të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse.

“Normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke adresuar të gjitha çështjet e pazgjidhura, është thelbësore për rrugën përkatëse evropiane të Kosovës dhe Serbisë dhe për qytetarët tuaj. Kjo është gjithashtu thelbësore për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal”, i ka shkruar Borrell Kurtit.

Sipas tij, kthimi i perspektivës evropiane të Kosovës në një realitet për qytetarët e saj gjithashtu kërkon një vazhdim të shpejtë të dialogut Beograd-Prishtinë të lehtësuar nga BE-ja dhe normalizimi gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë.

Rreziku që Kosovës t’i imponohet një zgjidhje e dëmshme në negociata me Serbinë, po konsiderohet i tejkaluar pas rikthimit të partneritet BE-SHBA në këtë proces. Ky bashkëpunim u konfirmua gjatë vizitës së emisarit të Brukselit për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčak.

Në një intervistë ekskluzive të përbashkët dhënë KOHËS, i dërguari i BE-së dhe zëvendësndihmësi i sekretarit të shtetit, Matthew Palmer, konfirmuan se Brukseli dhe Washingtoni punojnë së bashku për arritjen e një marrëveshjeje finale. Për SHBA-në marrëveshja nënkupton njohjen e ndërsjellë, ndërsa për BE-në hapjen e rrugës së anëtarësimit të Kosovës.

© KOHA Ditore

MASAT ANTI-COVID KANË PRODHUAR PAKËNAQËSI TE NJË PJESË E QYTETARËVE, E NDOSHTA DO TË PRODHJOJNË EDHE EFEKTE NEGATIVE

Qytetarë, zyrtarë qeveritarë e deputetë në Shqipëri për fundjavë

Rreth 30 mijë qytetarë ia kanë mësyre Shqipërisë të premten dhe të shtunën. Bashkë me ta edhe qeveritarë e deputetë.

Ndërkohë, ata që nuk e kishin këtë mundësi, kanë shfrytëzuar parqet e sheshet për të kaluar ditët e ngrohta me diell. Gjithë ky fluks i qytetarëve ka vënë në pikëpyetje efektshmërinë e masave të marra nga Qeveria për të parandaluar përhapjen e COVID-19

Sanie Jusufi

PRISHTINË, 11 PRILL - Relaksimi i masave anti-Covid në Shqipëri e ashpërsimi i tyre në Kosovë ka bërë që mbi 30 mijë qytetarë nga Kosova të kalojnë vikendin në Shqipëri. Vetëm në 24 orët e fundit, 15 mijë qytetarë të Kosovës kanë kaluar ku-firin Kosovë-Shqipëri.

Përveç qytetarëve edhe shumë zyrtarë qeveritarë e deputetë të Vetëvendosjes, kanë kaluar vikendin në Shqipëri, në përkrahje të Boiken Abazit, Iliaz Shehut dhe Kreshnik Merxhanit, kandidatë të pavarur në zgjedhjet e 25 prillit në Shqipëri, por

që janë propozuar nga dega e Vetëvendosjes në Tiranë.

Kjo ka acaruar qytetarët, të cilët kanë kritikuar këto veprime të zyrtarëve qeveritarë.

Në Kosovë, me gjithë mbylljen e kafiterive e restoranteve, qytetarë të shumtë janë parë në parqe dhe në sheshe të qytetit.

Pensionisti Bahtir Rama, ka thënë se ka dalë në shëtitje në park, pasi ka nevojë për ecje, por nuk arsyeton numrin e madh të njerëzve që kanë dalë pa maska dhe nuk mbajnë distancë. Sipas tij, kështu bartet sëmundja.

“Unë gjithmonë kam respektuar

rregullat dhe gjithmonë më ka dalë mirë, e unë këtu e ndiej një dhimbje të madhe, sepse nuk po punohet drejt, sepse nëse është për të gjithë, jo dikush me shku e me u shëtiti e ne të tjerët me qëndru mbyllur”, ka thënë ai.

Edhe Adem Jetullahu, qytetar nga Prishtina, ka thënë se gjithmonë frekuenton Parkun e qytetit pasi sipas tij, nuk ka ku të shkojë diku tjetër.

“Po gjithmonë dal këtu, sepse nuk kam ku të shkoj diku tjetër, pasi në shtëpi nuk po rrihet, po mërzitem. P, sipas meje, mirë ka bërë Qeveria që e ka bërë këtë mbyllje, vetëm shpresoj të punojë kështu”, ka thënë ai.

Ndërkohë, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka arsyetuar shkuarjen e madhe të qytetarëve në Shqipëri. Sipas tij, masat nuk e kanë shkaktuar fluksin e madh të qytetarëve që kanë kaluar fundjavën në Shqipëri.

“Për një kohë të gjatë Kosova ka qenë vendi i vetëm me masa tejet të liruara dhe në disproporcion me përqendësimin e situatës epidemiologjike. Në situata të rënuara, masat kufizuese janë dëshmuar të jenë të pazëvendësueshme”, ka thënë ai.

Ai thotë se bizneset e prekura nga këto masa nuk janë të mbyllura plotësisht, sepse synimi është që ekonomia të arrijë të mirëmbahet tek-

sa shëndeti publik të përmirësohet.

“Kufijtë tokësorë me shtetet fqinje janë të hapur. Qytetarët kanë të drejtë të udhëtojnë sipas nevojave të tyre, duke marrë parasysh respektimin e masave në vendin mikpritës dhe të atyre në Kosovë me rastin e kthimit. Fluksi i madh në pikat kufitare, me theks në drejtim të Shqipërisë, i regjistruar këtë fundjavë edhe mund të jetë ndikuar nga masat e fillimit të javës së kaluar, por nuk është shkaktuar i gjithi nga to”, ka theksuar ai.

Ai krahason numrin e vizitorëve me atë të vitit 2019, kur vendi nuk përballlej me pandemi.

“Sipas të dhënave zyrtare në dy ditët e fundit, të premten dhe të shtunën janë regjistruar rreth 29 mijë persona që kanë dalë jashtë vendit në drejtim të Shqipërisë. Sa për krahasim, në vitin 2019, atëherë kur nuk kishte fare pandemi, në një fundjavë të krahasueshme, sikurse ajo e 27, 28 dhe 29 prillit, që për shkak të Pashkëve ortodokse ishte fundjavë e zgjatur dhe me mot të ngrohtë sikurse i kësaj fundjave, rreth 30 mijë persona ishin regjistruar të kenë dalë jashtë vendit në drejtim të Shqipërisë. Pra, dallimi është shumë i vogël dhe nuk paraqet trend tjetër”, ka theksuar ai.

Kjo, sipas Kryeziut, dëshmon që fluksi i kësaj fundjave, sado që mund të jetë ndikuar, nuk është shkaktuar

nga masat kundër COVID-19, të futura në fuqi më 7 prill, e as nuk shpjgohet plotësisht përmes tyre.

“Masat janë vendosur për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve, megjithatë ato mund të arrijnë efektin vetëm nëse të gjithë së bashku tregojmë ndjeshmëri për ruajtjen e shëndetit tonë dhe të tjetrit. Krahas vaksinimit, nuk duhet të ndalen asnjëherë përpjekjet e përbashkëta për zbatimin e masave mbrojtëse, si nga qytetarët ashtu edhe nga institucionet e bizneset, në mënyrë që ta fitojmë sa më shpejtë betejën në luftën globale kundër pandemisë”, ka pohuar ai.

Ky postim i tij ka nxitur reagime të qytetarëve në rrjet, të cilët kanë pyetur se çfarë efektesh mund të kenë masat nëse ato nuk respektohen as nga zyrtarët qeveritarë.

Me masat e Qeverisë për të hyrë në Kosovë nga Shqipëria nuk nevojitet test PCR negativ apo izolim, pasi që as Shqipëria nuk kërkon një gjë të tillë.

Ndërkohë një pikë tjetër e vendimit thotë se qytetarët gjatë hyrjes në Kosovë duhet të paraqesin një test negativ të bërë më së largu në 72 orë para hyrjes në Kosovë, në të kundërtën duhet të vetizolohen për 7 ditë. Përfundim nga kjo masë bëhet për qytetarët që kanë dalë jashtë Kosovës në 24 orët e fundit.

© KOHA Ditore



Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka arsyetuar shkuarjen e madhe të qytetarëve në Shqipëri. Sipas tij, masat nuk e kanë shkaktuar fluksin e madh të qytetarëve që e kanë kaluar fundjavën në Shqipëri